



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Agrium" Sh.P.K. të datës 25.01.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me kontejner për mbeturina - ritender" me nr. të prokurimit 616-23-12035-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Agrium" Sh.P.K. e datës 25.01.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me kontejner për mbeturina - ritender" me nr. të prokurimit 616-23-12035-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatorit ekonomik "Agrium" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Agrium" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 23.01.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me kontejner për mbeturina - ritender" me nr. të prokurimit 616-23-12035-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë se tenderuesi i rekomanduar për këtë aktivitet të prokurimit nuk posedon autorizim nga prodhuesi përkatësisht autorizim në fjalë është i falsifikuar prandaj nuk e ka përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit fillimisht duhet sqaruar se këto pretendime i referohen kërkesës nr. 2 mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit, të formuluar si në vijim:

Kapaciteti teknik dhe profesional

2. Operatori ekonomik duhet të ofroj Autorizimin nga prodhuesi për produktet e ofruara

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kopjen e autorizimit nga prodhuesi te nensghkruar dhe te vulosuar

Në mesin e dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është gjetur se janë dorëzuar tri (3) autorizime nga tre (3) prodhues të ndryshëm për produktet e ofruara, të gjitha të nënshkruara dhe të vulosura sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Këto tre prodhues janë C-Trace GmbH, SSI Shafer GmbH dhe Sulo GmbH, pra që të tre janë prodhues gjerman me seli në Gjermani. Sidoqoftë pretendimi ankimor i parashtruesit është se autorizimi nga prodhuesi C-Trace është dokument i falsifikuar nga tenderuesi i rekomanduar. Përndryshe parashtruesi nuk e konteston në asnjë moment faktin se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar edhe dy autorizime tjera nga dy prodhues të tjerë. Ndërsa sa i përket dilemës nëse njëri nga këto autorizime është falsifikuar ose jo, fillimisht duhet sqaruar se Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues nuk ka as kapacitet por as kompetencë ligjore për të zhvilluar hetime apo për të zhvilluar ekzaminime teknike me qëllim që të konstatohet nëse dokumenti në fjalë është i falsifikuar ose jo. Falsifikimi i dokumenteve është inkriminuar sipas ligjeve në fuqi në shtetin e Kosovës dhe për këtë veprim kryesisht bartin përgjegjësi juridike individuale sipas legjislacionit përkatës. Në këtë drejtim tenderuesi i rekomanduar me rastin e ofertimit ka nënshkruar edhe deklaratë nën betim lidhur me vërtetësinë e dokumenteve me të cilat ka ofertuar. Rrjedhimisht tenderuesi i rekomanduar ka përgjegjësi nën betim sa i përket dokumenteve me të cilat ka ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë për të hetuar dhe për të konstatuar këtë fakt, ekzistojnë institucionet tjera kompetente.

Për aq sa ne si autoritet kontraktues kemi kompetencë sipas LPP, me qëllim të shqyrtimit të pretendimit ankimor nga parashtruesi, komisioni gjatë procedurës për rivlerësim ka kërkuar sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar respektivisht nga prodhuesi C-Trace me seli në Gjermani. Rrjedhimisht me datë 12.01.2024 prodhuesi C-Trace ka kthyer përgjigjen përmes së cilës ka njoftuar se ata kanë lëshuar autorizim për tenderuesin e rekomanduar "JV Horn & Co. Kosova Sh.P.K. and Knettenbrech + Gurdulic Umwelt GmbH" duke autorizuar atë për shitje dhe distribuim të produkteve tona. Njëkohësisht ka njoftuar se në tregun e Kosovës nuk posedon askush ekskluzivitetin e shtijes dhe distribuimin e produkteve të tyre. Megjithatë ata kanë konfirmuar se e njohin tenderuesin e rekomanduar në mënyrë të veçantë si partner dhe klient afatgjatë.

thank you for your e-mail.

We confirm that we issued a document of authorisation - "Manufacturer's Authorization Letter" as described above. This letter confirms that the economic operator group "JV Horn & Co. Kosova SHPK and Knettenbrech + Gurdulic Umwelt GmbH" is allowed to sell and distribute our products. This authorization covers the following products (Waste Management Solutions for Municipalities, Range of services (chips, read out scanners, systems, software, bin service, software and system service), which are manufactured and developed by us and meet our strict quality standards".

There is currently no exclusivity in the Kosovo market that could limit such activity. We particularly know Knettenbrech + Gurdulic Umwelt GmbH as a long-standing partner and customer.

We hope that we were able to help you with this information and are happy to answer any further questions.

Vlen të thuhet se pretendimet ankimore të parashtruesit janë mjaft kundërthënëse mes vete. Kjo për arsye se parashtruesi në një rën anë pretendon që tenderuesi i rekomanduar nuk posedon autorizim nga prodhuesi pasi që të njëjtin e ka falsifikuar dhe në anën tjetër përmes kërkesës për rishqyrtim ka thënë se *"Ne asnjeherë nuk e kemi mohuar se OE e shpallur fituese nuk është e autorizuar nga kompania prodhuese"*.

Është sinqerisht e papranuar nga Komisioni vlerësues si dhe Zyra e Prokurimit si nuk merret me thelbin e problemit (e cila është FALSIFIKIMI i dokumentit) dhe mundohet ta kamufloj problemin. Ne asnjeherë nuk e kemi mohuar se OE e shpallur fituese nuk është e autorizuar nga kompania prodhuese, por, ne kemi thënë që autorizimin të cilin e posedon OE e shpallur fituese është me detajet e tenderit paraprak, dhe për tenderin e "Ri-tenderuar" nuk ka kërkuar autorizim, me ç'rast ka falsifikuar/modifikuar dokumentin duke nderruar "Emrin e titullit të kontratës", "Numrin e Prokurimit", "Datën e dokumentit".

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 29.01.2024

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.